

Data 28.03.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHERBIME**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

MIREMBAJTJE E OBJEKTEVE NDERTIMORE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sherbime te riparimit dhe mirembajtjes – Kodi- 50000000-5

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**3 000 000 (Tremilion) lek pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, dhe 49 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*
- c. Analizat teknike të cmimeve për të gjitha zerat e preventivit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese përskualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhësi

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

### **Neni 82, i Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”**

*1.Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

### **Neni 83, i Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”**

*“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,*

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

### **a. License profesionale sipas modelit të leshuar MPPT e Shoqërise e vlefshme me kategorite:**

- NP-2 A
- NP-3 A
- NS-1 A
- NS-2 A
- NS-4 A

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

c. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik ose Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe të deklarojnë se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, si dhe një deklaratë nga vete drejtuesi teknik që është dakort të jete i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për nevojat e institucionit, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. CV perkatese
- ii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Institucioni yne kërkon si kusht për nevojat e subjektit që të ketë këto pika licence dhe drejtuesin teknikë për të realizuar shërbimin në cilësi shumë të mirë.

- a) **Kopje të deklaratimit të xhiros mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit e cila duhet të ketë një vlerë minimalisht sa fondi limit pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës;**
- b) **Kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve të fundit të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse;**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2021, 2022 dhe 2023 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

II. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a. Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, të paktën **40% e fondit limit pa tvsh**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit; ose

b. Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është të paktën sa dyfishi i fondit limit pa T.V.SH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siper permendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:

- Kontrate punimesh
- Situacionin përfundimtar
- Aktmarrjen ne dorëzim dhe/ose aktkolaudimi
- Vertetim realizimi
- FormularVleresimi

Pika 1/a plotësohet nga anëtari icili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Shenim! Per kontrata të realizuara me subjekte private duhet te paraqiten Kontrata, Situacioni, Fatura tatimore dhe vertetim realizimi.**

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, osedyfishi i

- Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te paraqesim vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore per vitet 2022-2023

Deklarate nga operatori ekonomik pjesemarres se i ka shlyer te gjitha detyrimet vendore per keto vite ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pasi institucioni yne duhet te sigurohet se cdo operator ushtron aktivitetin konform te gjitha dispozitave ligjor ne fuqi dhe eshte korrekt me pagimin e cdo detyrimi financiar qe ka.

**Një punësim mesatar i të paktën 35 personave, për periudhën Dhjetor 2023 deri ne Shkurt 2024 të vërtetuar me;**

-Vërtetim të lëshuar nga AdministrataTatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen perkatese

-List pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga AdministrataTatimore.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.*

*Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, me perjashtim te listepageses e cila duhet te paraqitet elektronikisht.*

Subjekti te kete drejtues teknikIng.Ndertimi, Ing.Mekanik, Ing.Mjedisi (Me certifikim per auditim mjedisor), Ing.Elektrik, Ing.Hidroteknik. Keto Inxhiniera duhet te jene te punesuar me kontrate pune me kohe te plote.

Per Inxhinierat e mesiperm te paraqiten kontratat e punes, cv dhe diplomat e tyre.

Njeri prej Ing.te jete i certifikuar si koordinator per sigurine ne pune.

Punonjes te certifikuar nga IQT (shoqeruar me kontrate pune dhe cv), me profesionet e ndryshme ne fushen e ndertimit, ku te jene: Manovrator 3, Teknik Ndertimi 2, Bojaxhi 2,Hekurthyes 2, Hidroziolues 2, Saldator 2, karpentier 2, Marangoz 1, Pllakashtrues 2, Specialist gipsi 1, Punetor d/alumini 1, suvatures 2, murator 4 dhe 4 punetore te tjere, te jene te deklaruar ne listepagesa me keto profesione. Per Teknikun e ndertimit dhe saldatorete te paraqiten edhe diploma/deftese e shkolles se mesme ose profesionale.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 4/c dhe 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pasi institucioni yne duhet te sigurohet se cdo operator ushtron aktivitetin konform te gjitha dispozitave ligjor ne fuqi dhe eshte korrekt me pagimin e cdo detyrimi financiar qe ka dhe te kete te punesuar keto specialiste te domosdoshem per te kryer sherbimet.

ç) Operatoret duhet te kene nje mareveshje te konkretizuar me nje venddepozitimi (subjekt te licencuar dhe te njohur nga organet ligjore) te mbetjeve te ndryshme ndertimore qe dalin gjate punimeve. Vendi i depozitimit duhet te jete brenda territorit administrativ te qarkut Shkoder.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se ne baze te vecantise qe paraqet ky prokurim eshte e nevojshme qe te gjitha materialet qe dalin gjate kryerjes se punimeve qe duhet te largohen nga objekti te hidhen ne nje venddepozitim te caktuar brenda Qarkut Shkoder.

Deri ditën e hapjes së ofertave operatorët ekonomik ofertues duhet të bëjnë paraqitjen e mostrave pranë protokollit të institucionit për BOJEN. Mostrat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike, sipas të gjitha përcaktimeve të bëra nga AK. Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja me specifikimet teknike përben kusht për skualifikim. Kostoja e paraqitjes së mostrave mbulohet nga vetë operatori ekonomik.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se duhet të paraqiten mostrat përkatëse pasi është e nevojshme që ato të jenë në përputhje me specifikimet teknike.

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës( shtojca 9)

<b>Nr</b>	<b>LLOJI I MAKINERIVE</b>	<b>PRONESIA</b>	<b>SASIA Minimumi</b>
	Kamioncin	ne pronesiose me qera	cope 1
	Kamion	ne pronesiose me qera	cope 1
	Autovinc	ne pronesiose me qera	cope 1
	Fadrome	Ne pronesiose me qera	Cope 1
	Karrocadore	ne pronesiose me qera	Cope 8
	Autobetoniere	ne pronesiose me qera	Cope 1

	Kokore	ne pronesiose me qera	40 cope
	Jelek per veshje	ne pronesiose me qera	40 cope
	Dorezapune	ne pronesiose me qera	40 cope
	Tabelasinjalizuese	ne pronesiose me qera	4 cope
	Saldatrice	Ne pronesiose me qera	2 cope
	Skeleri	Ne pronesiose me qera	800 m2
	Vegla pune si disk flesibel, mastar, karroce dore.	Ne pronesiose me qera	Nga 1 prejseciles

1. a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Lejeqakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, leje transporti, foto dhe duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi. Nëse mjetet janë të marra me qera, ofetuesi duhet të jetë i pajisur me licencë transporti për të tretë ose leje të transportit të jetë në emer të qeramarresit. Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira të paraqiten kontratë noteriale qiraje/huapërdorje me emër objekti dhe me afat të përcaktuar të cilat do të jenë në dizpozicion deri në realizimin e punimeve; dhe/ose kontratë noteriale qiraje/huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht me mandate pagesat sipas parashikimit ligjor për secilin nga automjetet dhe/ose makineritë/pajisjet e marra me qira.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

b) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese).

c) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi me qera me qëllim verifikimi).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti vlerëson se është e domosdoshme posedimi i dy mjeteve për të bërë transportin nga pika e shpërndarjes deri tek magazina e institucionit.

6-Subjektiduhettejeteipajisur me :

-Certifikate ISO 9001:2015

-Certifikate ISO 14001:2004

-Certifikate ISO 45001:2018

Certifikatat duhet te jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik, te gjithë operatorët duhet te kene certifikatat ne perputhje me perqindjen dhe punimet perkatese qe marrin persiper te realizojne.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se cdo subjekt pjesëmarrës duhet te jete i certifikuar per te garntuar edhe cilesine e produkteve objekt prokurimi.

NJESIA E PROKURIMIT